



UNIVERSITETI "UKSHIN HOTI" PRIZREN
UNIVERSITY "UKSHIN HOTI" PRIZREN

REKTORATI

Rruga e Shkronjave Nr. 1, 20000 Prizren -Kosovë; Tel:+383 (0) 29- 232 140; Homepage: www.uni-prizren.com

Ref. Nr.: _____

Datë ____ . ____ . ____

Senati i Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren, në mbledhjen e datës 22.09.2025 mori vendim që të shpallë:

KONKURS PLOTËSUES (Afati i III-të)

PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË LIRA NGA KONKURSI PLOTËSUES PËR PRANIMIN E STUDENTËVE NË VITIN E PARË TË STUDIMEVE NË NIVELIN BAÇELOR, PËR VITIN AKADEMIK 2025/2026

I. KUSHTET E PËRGJITHSHME

1. Universiteti "Ukshin Hoti" në Prizren, në vitin e parë të studimeve, në afatin plotësues të tretë të konkursit për vitin akademik 2025/2026, do të regjistrojë 174 studentë, prej të cilëve 174 studentë të rregullt.
2. Në kuadër të numrit të përgjithshëm të përcaktuar si në paragrafin 1, bazuar në UA nr. 09/2016 të MASHTI-it, Universiteti do të regjistrojë deri në 12 %, përkatësisht deri 51 studentë të rregullt nga komuniteti jo shumicë. Kuota prej 12% të vendeve të rezervuara për regjistrim të studentëve nga komuniteti jo shumicë do të shpërndahet në mënyrë proporcionale sipas përqindjes së numrit të përgjithshëm të studentëve për secilin program të fakulteteve veç e veç.
3. Në Universitet, në bazë të kuotave të përcaktuara nga MASHTI-i, në kuadër të numrit të përgjithshëm të studentëve, mund të regjistrohen deri në 5% përkatësisht deri në 27 kandidatë nga: Shqipëria, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Presheva, Bujanoci dhe Medvegja. Kandidatët të cilët kanë lindur në vendet e sipërsënuar, ndërsa shkollimin e mesëm e kanë mbaruar në Republikën e Kosovës, do t'iu nënshtrohen kushteve të njëjta për pranim si kandidatët nga Kosova.
4. Përjashtimisht kushteve të veçanta të përcaktuara për kandidatët si në pikën 2 dhe 3, nëse të njëjtit arrijnë të kualifikohen brenda numrit të paraparë si në pikën 1, atëherë këta kandidatë nuk do të llogariten në kuadër të kuotës së rezervuar.
5. Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren, mbi bazë të konsideratave humane, kandidatëve me nevoja të veçanta, me rastin e provimit pranues do t'ua shtoj nga 5 pikë bonus. Statusi i kandidatëve me nevoja të veçanta duhet të dëshmohet me certifikata përkatëse, të lëshuar nga institucionet gjegjëse.
6. Universiteti nuk do të mundësojë lehtësira për pranim nëse njëri prej kandidatëve binjakë nuk

- arrin të pranohet në programin e njëjtë apo të ndryshëm me binjakun tjetër.
7. Të drejtë pranimi në Universitetin "Ukshin Hoti" Prizren kanë të gjithë kandidatët kosovarë, të cilët shkollimin e mesëm e kanë përfunduar në njërën prej shkollave publike apo shkollave private të licencuara në Republikën e Kosovës dhe që e kanë diplomën për shkollimin e kryer.
 8. Në Universitet mund të pranohen edhe kandidatët nga shtetet e tjera në kushte të njëjta konkurrimi me kandidatët nga Kosova.
 9. Kandidatë jo kosovarë konsiderohen kandidatët të cilët shkollimin e mesëm e kanë mbaruar jashtë Kosovës.
 10. Vendimi për njohjen dhe për barasvlerën e diplomës merret nga MASHTI-i.
 11. Universiteti do të sigurojë përgatitjen e testeve për provim pranues në gjuhën në të cilën kandidatët kanë përfunduar shkollimin paraprak ose/dhe për të cilën deklarohen paraprakisht në formularin për vetëdeklarim, përveç në rastet specifike ku testi do të përgatitet në gjuhën në të cilën zhvillohet programi (p.sh. në programet e Fakultetit të Filologjisë).
 12. Njësitë akademike përkatëse me rastin e aplikimit të kandidatëve nga komuniteti jo shumicë bëjnë verifikimin e dokumentacionit pedagogjik duke përfshirë dëftesat dhe diplomat në gjuhën në të cilën kandidatët kanë përfunduar shkollimin e mesëm.
 13. Deklarimi i rrejshëm në formularin për vetëdeklarim, sipas nenit 391 të Kodit Penal (KODI NR. 04/L-082) të Republikës së Kosovës konsiderohet vepër penale.
 14. Kandidatët të cilët kanë të regjistruar një program studimi në cilindo nivel të studimit në kuadër të Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren nuk kanë të drejtë konkurrimi në programin tjetër studimi në Universitet pa përfunduar studimet në programin ku kanë qenë duke studiuar ose pa u çregjistruar nga programi aktual i studimeve.
 15. Kandidatët për pranim si studentë të Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren në vitin akademik 2025/26 nuk mund të konkurrojnë më shumë se në një fakultet apo program.

II. MËNYRA E PËRZGJEDHJES SË KANDIDATËVE

1. Përzgjedhja e kandidatëve për të gjitha fakultetet do të bëhet sipas kritereve si në vijim:
 - a) Për nxënësit që kanë diplomë për kryerjen e shkollës së mesme e nuk kanë pasur provim të maturës, numri maksimal i pikëve sipas kritereve vijuese është 100 pikë, dhe atë:
 - Suksesi në shkollën e mesme deri në 30 pikë; dhe
 - Suksesi në provim pranues deri në 70 pikë.
 - b) Për nxënësit që kanë diplomë për kryerjen e shkollës së mesme dhe e kanë dhënë me sukses provimin e maturës, numri maksimal i pikëve sipas kritereve vijuese është 100 pikë, dhe atë:
 - Suksesi në shkollën e mesme deri në 30 pikë;
 - Suksesi në maturë deri në 30 pikë; dhe,
 - Suksesi në provimin pranues deri në 40 pikë.
 - c) Provimi pranues hartohet me 100 pikë (ku sistemi sipas aplikuesit i konverton në 70 apo 40 pikë)
2. Të drejtë pranimi kanë vetëm kandidatët që arrijnë së paku 40% nga numri i pikëve të parapara në provimin pranues.

3. Kandidatët të cilët nuk arrijnë së paku 40% nga numri i pikëve të parapara në provim pranues nuk mund të pranohen edhe nëse mbeten vende të paplotësuara sipas konkursit.
4. Përjashtimisht kushteve të përgjithshme të përcaktuara në paragrafin 2 dhe 3 të pikës II, kandidatët të cilët konkurrojnë sipas kriterëve të përcaktuara si në paragrafin 2 dhe 3 të pikës I, të drejtë pranimi kanë vetëm ata studentë që arrijnë së paku 30% nga numri i pikëve të parapara për provimin pranues, vendet e lira të cilat mbesin nga pika 2 dhe 3 nuk zëvendësohen.
5. Fakultetet e organizojnë mbajtjen e provimit pranues në lëndët mësimore të cilat i caktojnë vetë fakultetet.
6. Fakultetet janë të obliguara që listën e kandidatëve që kanë konkurruar, t'ia dërgojnë Rektoratit të Universitetit dhe ta publikojnë në ueb-faqen e Fakultetit.

Nëse numri i pikëve të disa kandidatëve të ranguar si të fundit në listën e të pranuarve është i barabartë me kandidatët tjerë jashtë numrit të planifikuar për pranim, zgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të suksesit të provimit pranues, e nëse edhe pikët e provimit pranues janë të njëjta atëherë do të merret parasysh sukcesi i shkollës së mesme.

III. AFATET E KONKURSIT

Për regjistrimin e studentëve në vitin e parë të studimeve, oraret do të jenë si në vijim:

1. **Aplikimi dhe dorëzimi i dokumentacionit, bëhet prej 26.09.2025 deri më 29.09.2025, nga ora 09:00-16:00 (ditë pune përfshirë edhe të shtunën) ditën e fundit dokumentet pranohen deri në ora 16:00. Provimi pranues do të mbahet më 30.09.2025, duke filluar prej orës 09:00 (shih tabelën me orarin e mbajtjes së provimit pranues).**
2. Kandidatëve u rekomandohet që para paraqitjes në konkurs të bëjnë kopje të mjaftueshme të dokumenteve, sepse dokumentet origjinale nuk do të mund t'i tërheqin deri në diplomim apo çregjistrim nga fakulteti.
3. Me rastin e paraqitjes, kandidatët duhet të sjellin këto dokumente:
 - a) *Ekstraktin e lindjes (origjinale)- jo më të vjetër se 6 muaj;*
 - b) *Dëftesat e të gjitha klasave të shkollës së mesme (origjinale, të noterizuara ose dublikatë),*
 - c) *Diplomën e kryerjes së shkollës së mesme (origjinale, të noterizuar ose dublikatë),*
 - d) *Dëftesa e maturës, nëse ka pasur provim të maturës (origjinale, të noterizuar ose dublikatë),*
 - e) *Kopjen e letërnjoftimit,*
 - f) *Fletëparaqitja e plotësuar shkarkohet gjatë aplikimit online nga interneti: Vegëza për aplikim online përmes internetit është: www.smu.uni-prizren.com,*
 - g) *Vendimin mbi njohjen e shkollimit jashtë vendit (vendimi merret nga MASHTI- vlen për kandidatët të cilët shkollimin e mesëm e kanë mbaruar jashtë Kosovës) .*
4. Me rastin e aplikimit, të gjithë kandidatët janë të obliguar që dokumentet e nevojshme si në pikën 3 të këtij neni t'i dorëzojnë në sportelet e fakulteteve.
5. Datat e mbajtjes së provimeve pranuese në fakultetet e ndryshme janë të shpallura në vijim:

Orari i mbajtjes së provimit pranues është më datë 30.09.2025

Nr.	Data	Fakulteti	Programi	Prej	Deri	Grupi
1	30.09.2025	Ekonomik	Menaxhment Ndërkombëtar	09:00	10:30	RR
2	30.09.2025	Edukim	Program Fillor - Bos dhe Tur.	09:00	10:30	RR
3	30.09.2025	Filologji	Gjuhë dhe Letërsi Angleze	09:00	10:30	RR
4	30.09.2025	FSHK	Teknologjitë e Informacionit dhe Telekomunikimi	09:00	10:30	RR
5	30.09.2025	FSHK	Dizajn Softueri, Baçelor profesional	09:00	10:30	RR
6	30.09.2025	FSHK	TIT - Bos.	09:00	10:30	RR
7	30.09.2025	Juridik	Juridik i Përgjithshëm	09:00	10:30	RR

Shpallja e rezultateve preliminare do të bëhet më 30.09.2025 në ora 12:00 në ueb-faqen zyrtare të Universitetit.

Afati për ankesa është deri më 01.10.2025 deri ora 12:00 AM, ndërsa shqyrtimi i tyre do të bëhet më 01.10.2025 duke filluar nga ora 13:00.

Ndërsa, shpallja e rezultateve përfundimtare do të bëhet më datë 01.10.2025 më së largu ora 15:00

Regjistrimi dhe fotografimi i studentëve të pranuar do të bëhet më 02.10.2025 prej orës 09:00-16:00 (shih tabelën e mëposhtme).

Kandidatët të cilët nuk regjistrohen (fotografohen) sipas datave të shënuara do ta humbasin mundësinë e regjistrimit, andaj ju lutemi që t'i përmbaheni afateve të caktuara.

Orari i regjistrimit dhe fotografimit të studentëve të pranuar

Nr.	Fakulteti	Departamenti	Data e fotografimit	Ora
1	Ekonomik			
		Menaxhment Ndërkombëtar	02.10.2025	09:00 - 16:00
2	FSHK	Teknologjitë e Informacionit dhe Telekomunikimi (Shq. - Bosh.)	02.10.2025	09:00 - 16:00
		Dizajn Softueri, Baçelor profesional	02.10.2025	09:00 - 16:00
3	Edukim	Fillor (Tur. Bos.)	02.10.2025	09:00 - 16:00
4	Filologjisë	Gjuhë dhe Letërsi Angleze	02.10.2025	09:00 - 16:00
5	Juridik	Juridik i Përgjithshëm	02.10.2025	09:00 - 16:00

Kandidatët e pranuar me rastin e regjistrimit duhet të paraqesin:

1. Fletëregjistrimin e plotësuar i cili merret me rastin e fotografimit;
2. Një fotografi (formati 4.5 x 6 cm) të cilat duhet të bëhen nga një fotograf profesionist.

Për informata më të hollësishme kandidatët duhet ta vizitojnë ueb-faqen zyrtare: www.uni-prizren.com

I. Numri i studentëve të cilët do të pranohen në Universitetin “Ukshin Hoti” Prizren - sipas programeve është si në tabelën:

Nr.	Fakulteti	Drejtimi	Kodi i programit	Për studime të rregullta	Për komunitete 12%	Kandidatë nga Shqipëria, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Presheva, Bujanoci dhe Medvegja 5%	Total
1	Fakulteti Ekonomik	Menaxhment Ndërkombëtar	2	21	14	7	42
2	Fakulteti i Edukimit	Programi Fillor - Bos.	11	10	0	1	11
3	Fakulteti i Edukimit	Programi Fillor - Tur.	13	11	0	0	11
4	Fakulteti i Shkencave Kompjuterike	Dizajn Softueri, Bachelor profesional	29	34	18	7	59
5	Fakulteti i Shkencave Kompjuterike	Teknologjitë e Informacionit dhe Telekomunikimi	7	0	2	6	8
6	Fakulteti i Shkencave Kompjuterike	Teknologjitë e Informacionit dhe Telekomunikimi - Bos.	25	0	0	1	1
7	Fakulteti i Filologjisë	Gjuhë dhe Letërsi Angleze	23	20	3	5	28
8	Fakulteti Juridik	Juridik i Përgjithshëm	5	0	14	0	14

Vini re: Në tabelën e paraqitur me kuaota për nxënësit që kanë përfunduar mësimin në gjuhën turke dhe boshnjake, do të merret parasysh gjuha e shkruar në dokumentacionin pedagogjik, dëftesa dhe diploma. Përfundimi nga vërejtja e lartpërmendur përbëjnë kandidatët të cilët vijnë nga komunat në të cilat nuk organizohet mësimi në këto dy gjuhë. Këta kandidatë duhet ta plotësojnë formularin për vetëdeklarim lidhur me përkatësinë e tyre etnike.

LËNDËT NË PROVIM PRANUES:

1. **Menaxhment Ndërkombëtar:** Hyrje në ekonomi, Matematikë
2. **Gjuhë dhe Letërsi Angleze:** Gjuhë dhe Letërsi Angleze
3. **Teknologjitë e Informacionit dhe Telekomunikimi:** Kompjuterikë (Programim, Baza e të dhënave, Rrjetet kompjuterike) dhe Matematikë
4. **Dizajn Softueri, Baçelor profesional:** Kompjuterikë (Programim, Baza e të dhënave, Rrjetet
5. **Juridik i Përgjithshëm:** Fillet e së drejtës, E drejta kushtetuese dhe Gjuhë shqipe

Në Gjuhën Boshnjake:

6. **Programi Fillor:** Gjuhë amtare (testi i të lexuarit të kuptueshëm) dhe Matematikë
7. **Teknologjitë e Informacionit dhe Telekomunikimi:** Kompjuterikë (Programim, Baza e të dhënave, Rrjetet kompjuterike) dhe Matematikë

Në Gjuhën Turke:

8. **Programi Fillor:** Gjuhë amtare- testi i të lexuarit të kuptueshëm dhe Matematikë